

V E N D I M
Nr.506, datë 13.8.1998

**PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT TË QEVERISË SHQIPTARE PËR VITIN 1998 PËR
PROJEKTIN E "RUAJTJES SË LIQENIT TË OHRIT"**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, si dhe të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontributit të Qeverisë Shqiptare për vitin 1998, për shumën prej 3 000 000 lekësh (kundërvlehtë e 20 000 USD) për fillimin e këtij projekti, në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 9.5.1998 "Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si administruese e fondeve për projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit dhe procesverbalin e bisedimeve përkatëse".

2. Ky fond, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1998.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano